

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6312
E enjte, 13 maj 2021
çmimi 0.40 €

Arrijnë në Kosovë
edhe 38 400 doza të
vaksinës kundër Covidit

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE" VEDAT SAHITI, KRYEIMAM I BIK-ut FAQE 3

T'I RESPEKTOJMË MASAT KUNDËR COVIDIT GJATË FESTËS SË BAJRAMIT



"Epoka e re" të gjithë
shqiptarëve të besimit
islam ua uron festën e
Fitër Bajramit!

OPINION

**STRATEGJIA E SHËRBIMIT
SEKRET SERB PËR TA
SHKATËRRUAR STRUKTURËN
E UÇK-SË PAS VITIT 2000 E
KËNDEJ (3) F. 10**

Faton
B. MEHMETAJ



AKTUALE

**DEPUTETËT KËRKOJNË NGA
DREJTORI I AKI-së INFORMACIONE
PËR INCIDENTIN NË VERI
DHE 'NON-PAPER'-in F. 6**

**PSD-ja, AKSION PARA MSH-SË,
KËRKON DORËHEQJEN
E MINISTRIT VITIA F. 7**

**KONJUFCA DHE KURTI NDEROJNË
HEROIN AGRON RRAHMANI NË
23-VJETORIN E RËNIES SË TIJ F. 3**

EKONOMI

**RRITET KONSUMI I ENERGJISË
ELEKTRIKE NË KOSOVË F. 9**

**RRETH 350 MINATORË NUK
SHKOJNË NË PUNË, DUAN PAGAT F. 9**

Kryeimami i Bashkësisë Islame i Kosovës (BIK), Vedat Sahiti, u ka bërë thirrje besimtarëve myslimanë që t'u përmbahen rekomandimeve të institucioneve shëndetësore gjatë festës së Fitër Bajramit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se është obligim fetar dhe moral që në pandemi të kujdesemi maksimalisht për ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit tonë. Sahiti ka treguar se Fitër Bajrami do të falet në xhami, por duke respektuar masat kundër koronavirusit



VAKSINIMI DHE LEHTËSIMI I PASOJAVE EKONOMIKE TË SHKAKTUARA NGA PANDEMIA, PRIORITETE URGJENTE TË QEVERISË KURTI

Qeveria e Kosovës tashmë ka publikuar programin qeverisës 2021-2025. Sipas programit qeverisës katërvjeçar, qeveria Kurti do të merret me dy prioritetet të cilat i ka vlerësuar urgjente. Prioriteti i parë ka të bëjë me vaksinimin kundër Covidit të 60 për qind të popullsisë brenda këtij viti. Prioriteti i dytë i qeverisë ka të bëjë me lehtësimin e pasojave ekonomike dhe sociale të shkaktuara



nga pandemia. Qeveria Kurti në programin e vet i ka kushtuar rëndësi

sundimit të ligjit, zhvillimit ekonomik, sigurisë publike dhe politikës së jashtme në të cilën përfshihet edhe dialogu me Serbinë. Në këtë kontekst, qeveria do të angazhohet në dialogun me Serbinë me synim të normalizimit përfundimtar të marrëdhënieve dypalëshe. Për këtë proces, ku lehtësuese është BE-ja, qeveria synon të koordinohet edhe me ShBA-në dhe opozitën FAQE 4-5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Përplasje në Senat rreth ndryshimeve në ligjin zgjedhor

UASHINGTON, 12 MAJ - Në Senatin Amerikan ka nisur një betejë mbi zgjedhjet në këtë shtet, derisa demokratët janë duke u përpjekur ta miratojnë një projektligj gjithëpërfshirës që ata kanë thënë se do ta zgjeronte qasjen e amerikanëve te votimi. Masa ligjore vjen ndërsa disa shtete të kontrolluara nga republikanët po vendosin kufizime të reja në këtë drejtim.

Komisioni i Senatit për Rregulloren dhe Administratë ka debatuar rreth një projektligji prej 886 faqesh, hartuar nga demokratët me kontributin e disa zyrtarëve shtetërorë të cilët merren me administrimin e proceseve zgjedhore.

Ndër nenet e përfshira në projektligj është ai që parashikon një zgjerim të votimit përmes postës, një formë që u përdor gjerësisht në zgjedhjet presidenciale të vitit të kaluar për shkak të pandemisë së koronavirusit. Gjithashtu, është parashikuar një zgjatje e orareve të votimit në rastet kur shkohet fizikisht për të votuar në qendrat e votimit.

Shfaqja e pazakontë e udhëheqësve të lartë demokratë dhe republikanë të Senatit gjatë punimeve të komisionit ka nënvizuar rëndësinë e asaj çka është në lojë, ndërsa vëmendja po



përqendrohet te zgjedhjet për Kongresin që mbahen në nëntor të vitit 2022.

“Projektligji i paraqitur para këtij komisioni kërkon ta bëjë më të lehtë, jo më të vështirë qasjen te votimi”, ka thënë udhëheqësi i shumicës së Senatit, demokrati Chuck Schumer.

Në pjesën dërrmuese të komenteve të tij ai është përqendruar te ndryshimet në ligjin zgjedhor të miratuar këtë vit nga ato shtete të cilat kontrollohen nga republikanët, duke i karakterizuar ato si anti-demokratike dhe duke thënë se “mbartin shijen e ndrydhjes (së votës)”.

Ligjet e Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit shkojnë përtej reformës zgjedhore, duke u përpjekur t'i japin fund qasjes së njëanshme politike të njësisë administrative, e të pengojnë që në fushata zgjedhore të përdoren “para të cilave nuk u dihet origjina” për shkak të fshehjes së identitetit të donatorëve.

Për muaj të tërë ish-presidenti Donald Trump ka bërë pohime të pabazuara në fakte se ai i humbi zgjedhjet e vitit 2020 për shkak të manipulimeve masive me votat. Sipas ekspertëve, manipulimi i zgjedhjeve është

jashtëzakonisht i rrallë në Shtetet e Bashkuara.

Një numër i madh gjykatash si dhe zyrtarë shtetërorë e federalë që janë marrë me administrimin e zgjedhjeve i kanë hedhur poshtë pretendimet e Trumpit.

Të martën udhëheqësi i republikanëve në Senat, Mitch McConnell, ka thënë se projektligji i demokratëve nuk ishte asgjë më shumë sesa një përpjekje për kapje të pushtetit. “Ky ligj do t’u krijonte demokratëve në Uashington mundësinë të diktonin kushtet e garave për rizgjedhje, duke rishkruar të gjitha ligjet zgjedhore të 50

shteteve”, ka thënë McConnell.

Projektligji është duke u përballur me mosmarrëveshje të gjata në Senat. Për miratimin e tij demokratëve do t’u nevojiteshin votat e të paktën 10 republikanëve.

Në mars, Dhoma e Përfaqësuesve e kontrolluar nga demokratët ka miratuar një projektligj të ngjashëm me versionin e Senatit, por pa mbështetjen e republikanëve.

Debatet në Kongres vijnë pas miratimit nga shteti i Xhorxhias në muajin mars të një ligji zgjedhor të propozuar nga republikanët që ndalon, ndër të tjera, t’u jepet ujë apo ushqim atyre zgjedhësve që presin në radhë të gjata për të votuar.

Një sondazh i muajit mars zhvilluar nga “Reuters” dhe kompania “Ipsos” ka dalë në përfundimin se për 81 për qind të të rriturve në ShBA ishte “shumë” ose “disi” e rëndësishme që qeveria ta bënte më të lehtë procesin e votimit. Por i njëjti sondazh ka treguar se 74 për qind e shohin po aq të rëndësishme vendosjen e kufizimeve të reja në votim për t’i mbrojtur zgjedhjet nga manipulimet.

/VOA/

Mijëra persona marshojnë në rrugët e Uashingtonit në mbështetje të Palestinës

UASHINGTON, 12 MAJ - Mijëra persona në një marshim të mbajtur në Uashington të ShBA-së kanë shprehur mbështetje për Palestinën dhe reagan ndaj administratës së Izraelit dhe të ShBA-së.

Një protestë në mbështetje të Palestinës u mbajt përpara Departamentit Amerikan të Shtetit, ku protestuesit e mbledhur shfaqën reagimet e tyre ndaj administratës së ShBA-së dhe Departamentit Amerikan të Shtetit.

Në protestë, krahas një numri të madh të palestinezëve, turqve dhe amerikanëve, dhanë mbështetje edhe grupet hebreje ortodokse. Po në protestë mbajti fjalim edhe anëtarja myslimane me origjinë palestineze në Dhomën e Përfaqësuesve të



ShBA-së, Rashida Tlaib, e cila adresoi fjalë të ashpra ndaj Izraelit.

Në fjalën e saj, Tlaib tha se praktikat “raciste” si dhe

sulmet e Izraelit ndaj civilëve ditët e fundit janë kategorikisht të

papranueshme dhe se mbështetja e Qeverisë së

ShBA-së për Izraelin është kthyer në presion për Palestinën.

Më pas, turma, numri i së cilës u rrit menjëherë, duke arritur

në mijëra, filloi të marshojë në rrugët e Uashingtonit. Gjithashtu, mijëra persona kanë mbërritur edhe përpara Shtëpisë së Bardhë nën shoqërimin e sloganeve dhe flamujve palestinezë në duar. Të tubuarit përpara Shtëpisë së Bardhë mbajtën protestën nën shoqërimin e sloganeve “liri për Palestinën” dhe me slogane kundër ShBA-së dhe Izraelit.

Kreu i organizatës “Myslimanët Amerikanë për Palestinën”, Osama Abu Irshaid, institucionit organizator të protestës, është shprehur se “e gjithë bota duhet t’i kundërshtojë praktikën raciste të Izraelit. Është e pamundur që ta pranojmë këtë mbështetje që ShBA-ja jep ndaj Izraelit”.

FLET PËR "EPOKËN E RE" VEDAT SAHITI, KRYEIMAM I BIK-UT

T'i respektojmë masat kundër Covidit gjatë festës së Bajramit

Kryeimami i Bashkësisë Islame i Kosovës (BIK), Vedat Sahiti, u ka bërë thirrje besimtarëve myslimanë që t'u përmbahen rekomandimeve të institucioneve shëndetësore gjatë festës së Fitër Bajramit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se është obligim fetar dhe moral që në pandemi të kujdesemi maksimalisht për ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit tonë. Sahiti ka treguar se Fitër Bajrami do të falet në xhami, por duke respektuar masat kundër koronavirusit



falë mbështetjes së partnerëve dhe donatorëve vullnetmirë vendorë, nga diaspora dhe të jashtëm.

"Epoka e re": Është viti i dytë që muajin Ramazan po e presim ndryshe. Për shkak të pandemisë, besimtarët nuk kanë mundur të shkojnë si zakonisht në iftare te njëri-tjetri. Si ka qenë ky muaj për BIK-un dhe sa ka ndikuar pandemia në të ardhurat e kësaj bashkësie?

Sahiti: Gjendja pandemike e ka rënduar jetën sociale dhe ekonomike për të gjithë. S'ka dyshim se edhe ne si Bashkësi fetare jemi ndikuar nga kjo gjendje dhe kemi pasur vështirësi të mëdha për funksionimin normal gjatë kësaj periudhe. Ne si institucion dhe si Bashkësi kemi pasur rënie të theksuar të të hyrave, qoftë nga pagesa e anëtarësisë, qoftë nga të hyrat e Zekatit dhe të Fitrave. Duke pasur parasysh faktin se këto të hyra jepen në bazë vullnetare, pa dyshim se kjo rënie e të hyrave financiare ka ndikuar në masë të madhe për funksionimin e institucioneve dhe të organeve të Bashkësisë Islame të Kosovës. Por, megjithatë, falënderojmë Zotin që, pavarësisht prej vështirësive, ia kemi dalë mirë.

"Epoka e re": BIK-u vazhdimisht ka pasur kërkesa të caktuara ndaj institucioneve të Kosovës, që kanë pasur të bëjnë me mesimbesimin, çështjen e financimit të bashkësive fetare etj. A ia keni adresuar këto kërkesa qeverisë së re?

Sahiti: Bashkësia Islame e Kosovës, sikurse edhe bashkësitë e tjera fetare në vend, në mungesë të ligjit që përcakton qartë pozitën juridike të bashkësive fetare, pa dyshim se ka vështirësi të mëdha për funksionim normal e të qëndrueshëm.

Besoj se kjo është kërkesa jonë parësore si Bashkësi Islame dhe në këtë kuadër mendojmë se mund të zgjidhen edhe një mori problemesh dhe kërkesash të tjera që mund t'i kemi ne si Bashkësia më e madhe fetare në vend për të mirën e besimtarëve.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 MAJ - Kryeimami i Bashkësisë Islame i Kosovës, Vedat Sahiti, ka kërkuar nga besimtarët myslimanë që të kenë kujdes dhe t'i respektojnë masat kundër Covidit gjatë festës së Fitër Bajramit. Ai ka thënë se në kohë pandemie është obligim moral dhe fetar që çdo kush të kujdeset për ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se jeta është dhunti e të Zotit dhe ajo duhet të ruhet si amanet i shenjtë. "Apelojmë te të gjithë besimtarët që edhe gjatë kësaj feste të kujdesen për veten e tyre, t'i kushtojnë kujdes higjienës personale, ta ruajnë shëndetin dhe t'u përmbahen rekomandimeve të institucioneve tona shëndetësore ngaqë jeta është dhunti e të Madhit Zot dhe ajo duhet të ruhet si amanet i shenjtë", ka thënë Sahiti.

Ai ka deklaruar se për shkak të pandemisë janë anuluar pritjet tradicionale për urim në Kryesinë e Bashkësisë Islame. "Meqë jemi në kohë pandemie, ne kemi për obligim moral, fetar dhe njerëzor që të kujdesemi maksimalisht për ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit tonë, prandaj ne si Bashkësi Islame kemi anuluar edhe pritjen tradicionale për urim në Kryesinë e Bashkësisë Islame dhe u kemi rekomanduar vazhdimisht besimtarëve që këto vizita mos të bëhen shkak për ta rrezikuar shëndetin e të dashurve tanë, në veçanti të prindërve dhe të gjyshërve në moshë të shtyrë", është shprehur ai.

Më tutje, kryemami ka sqaruar

kushtet në të cilat do të falet namazi i Fitër Bajramit. "Për dallim nga viti i kaluar, këtë vit do ta kemi kënaqësinë që namazin e Fitër Bajramit ta falim në xhamitë tona, ndërsa namazin e sabahut do ta falim në shtëpi si një masë preventive për shkak të mundësisë së infektimit nga qëndrimi i gjatë brenda objekteve të mbyllura", ka thënë Sahiti.

"Epoka e re": Z. Sahiti, të mërkurën përfundon muaji i Ramazanit, ndërsa të enjten është dita e parë e festës së Fitër Bajramit. A do të ketë falje të namazit të Bajramit këtë vit?

Sahiti: Pas një sakrifice dhe përkushtimi njëmuor të besimtarëve gjatë gjithë muajit të bekuar Ramazan, ne me plot gëzim ditën e enjte do t'u mësojmë xhamive për ta falur namazin e Fitër Bajramit si shenjë falënderimi e madhërimi për Krijuesin Fuqplotë. Kjo festë madhore vjen pas kryerjes dhe përmbushjes së një prej pesë obligimeve (kushteve) të fesë islame.

Për dallim nga viti i kaluar, këtë vit do të kemi kënaqësinë që namazin e Fitër Bajramit ta falim në xhamitë tona, ndërsa namazin e sabahut do ta falim në shtëpi, si një masë preventive, për shkak të mundësisë së infektimit nga qëndrimi i gjatë brenda objekteve të mbyllura.

"Epoka e re": Për festën e Bajramit vizitat në farefisni janë të pashmangshme. Meqenëse në kohë pandemie këto vizita nuk janë të pëlqyera, cili është mesazhi juaj për besimtarët?

Sahiti: Festat tona fetare tradicionalisht manifestohen

dhe karakterizohen nga vizitat e

ndërsjella te familjarët, miqtë e dashamirët për faktin se feja jonë e pastër i jep një rëndësi të veçantë kultivimit të marrëdhënieve familjare dhe ndërnjerëzore. Meqë jemi në kohë pandemie, ne kemi për obligim moral, fetar dhe njerëzor që të kujdesemi maksimalisht për ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit tonë, prandaj ne si Bashkësi Islame kemi anuluar edhe pritjen tradicionale për urim në Kryesinë e Bashkësisë Islame dhe u kemi rekomanduar vazhdimisht besimtarëve që këto vizita mos të bëhen shkak për ta rrezikuar shëndetin e të dashurve tanë, në veçanti të prindërve dhe gjyshërve në moshë të shtyrë. Apelojmë te të gjithë besimtarët që edhe gjatë kësaj feste të kujdesen për veten e tyre, t'i kushtojnë kujdes higjienës personale, ta ruajnë shëndetin dhe t'u përmbahen rekomandimeve të institucioneve tona shëndetësore ngaqë jeta është dhunti e të Madhit Zot dhe ajo duhet të ruhet si amanet i shenjtë.

"Epoka e re": Cilat kanë qenë aktivitetet e BIK-ut gjatë këtij muaj? Sa keni arritur t'u dilni në ndihmë besimtarëve gjatë kësaj

kohe?

Sahiti: Kryesia e Bashkësisë Islame, në vigjilje të muajit të begatë Ramazan, ka miratuar një platformë të veçantë lidhur me punët, detyrat dhe aktivitetet që do të realizoheshin gjatë këtij muaji të bekuar, gjithnjë duke marrë parasysh masat kundër Covidit. Për realizimin dhe zbatimin e kësaj platforme kanë qenë të përfshira të gjitha drejtoritë dhe të gjithë sektorët e Kryesisë së Bashkësisë Islame, përfshirë këtu edhe këshillat vendore dhe institucionet e tjera të Bashkësisë Islame. Për shkak të masave kundër Covidit një sërë projektesh i kemi anuluar dhe ndërkohë jemi fokusuar më shumë në produksionin tonë, duke realizuar një numër të madh emisionesh, ligjëratash dhe kronikash të cilat i kemi transmetuar në faqet tona zyrtare dhe besojmë se ato e kanë zbutur në masë të madhe mospraninë fizike të ligjëruesve nëpër xhami. Ndërsa sa iu përket ndihmave humanitare dhe mbështetjes së shtresave me gjendje të rëndë sociale, ne gjatë gjithë muajit Ramazan ia kemi dalë të ndihmojmë një numër të madh familjesh skamnore nga fondi i Zekatit dhe Sadakatul Fitrit përmes shoqatës sonë "Bereqeti", si dhe

Myftiu Tërnavë uron besimtarët myslimanë për festën e Bajramit

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Kryetari i Bashkësisë Islame i Kosovës (BIK), myftiu Naim Tërnavë, ka uruar të gjithë besimtarët myslimanë për përfundimin e muajit të ramazanit dhe për festën e Fitër Bajramit. Me këtë rast, ai ka kërkuar nga besimtarët që t'i respektojnë masat kundër

Covidit. "Ne nesër kemi festë dhe bashkërisht do të jemi në xhamitë për ta falur namazin e Fitër Bajramit, por të kemi kujdes se virusi ende është në mesin tonë andaj, për ta ruajtur veten dhe shëndetin publik, ne kemi hequr dorë nga ana ceremoniale e manifestimit tradicional të

Bajramit. Në xhami do të jemi duke i respektuar protokollet kundër Covidit dhe për ta falur vetëm namazin e Fitër Bajramit. Ju ftoj që të bëni kujdes edhe me vizitat tradicionale të Bajramit, do ta ruajmë karakterin e festës, do të jemi pranë njëri-tjetrit, por do të kemi kujdes për shëndetin publik

sepse rreziku nga pandemia nuk ka kaluar. Vëllezër dhe motra, duke lutur Zotin që ta ketë pranuar agjërimin, lutjet, ibadetet e punët tona të mira, kudo që jeni, ju përgëzoj e ju uroj të gjithëve festën e Fitër-Bajramit. Me hair e me të mira na qoftë Fitër Bajrami!", ka thënë Tërnavë në urimin e tij.



QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PUBLIKON PROGRAMIN QEVERISËS 2021-2025

Vaksinimi dhe lehtësimi i pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia, prioritete urgjente të qeverisë Kurti



250 eurosh për 6 muajt e pushimit të lehonisë. Po ashtu, do t'i rishikojmë dhe ristrukturojmë skemat aktuale sociale dhe pensionale nëpërmjet pastrimit të listave të përfituesve të tyre", është thënë në programin qeverisës 2021-2025.

Sundimi i ligjit dhe padia për gjenocid kundër Serbisë

Qeveria e Kosovës në planin e saj qeverisës i ka kushtuar rëndësi edhe sundimit të ligjit dhe politikës së jashtme. Sa i përket sundimit të ligjit, qeveria do të angazhohet në procesin e vettingut. "Vetingu do të jetë instrument kyç për verifikimin e integritetit, profesionalizmit dhe kontrollin e pasurisë të subjekteve të vettingut. Procesi i vettingut do të jetë i drejtë, gjithëpërfshirës, me konsultime të gjëra publike me ekspertë të fushës, shoqërinë civile, botën akademike dhe partnerët ndërkombëtarë", është thënë në programin qeverisës të publikuar nga qeveria Kurti.

Në kuadër të sundimit të ligjit, Qeveria e Kosovës synon të ngrehë padi për gjenocid kundër Serbisë. "Njëkohësisht, do ta përgatisim padinë kundër Serbisë për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Po ashtu, do të angazhohemi për hartimin e politikave për drejtësi tranzicionale. Nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse, do ta bëjmë identifikimin dhe promovimin e proceseve të ndryshme që do t'u garantojnë viktimave të krimeve të drejtën për drejtësi dhe për të vërtetën. Ndër të tjera, do të zhvillojmë një platformë reparative, e cila do ta synojë përlogaritjen e dëmeve njerëzore dhe materiale të shkaktuara gjatë luftës", është thënë në këtë program qeverisës. Një rëndësi të veçantë në programin qeverisës i kushtohet edhe sigurisë publike, mbrojtjes, barazisë gjinore, procesit eurointegruar, procesit të liberalizimit të vizave, modernizimit të administratës publike, komuniteteve, bizneseve, luftimit të informalitetit, investimeve publike, infrastrukturës, arsimit, kulturës, rinisë, sporti, bujqësisë, mjedisit, banimit të përballueshëm social etj.

Politika e jashtme dhe dialogu me Serbinë

Prioriteti kryesor i Qeverisë së Kosovës, sipas programit qeverisës 2021-2025, do të jetë

Qeveria e Kosovës tashmë ka publikuar programin qeverisës 2021-2025. Sipas programit qeverisës katërvjeçar, qeveria Kurti do të merret me dy prioritete të cilat i ka vlerësuar urgjente. Prioriteti i parë ka të bëjë me vaksinimin kundër Covidit të 60 për qind të popullsisë brenda këtij viti. Prioriteti i dytë i qeverisë ka të bëjë me lehtësimin e pasojave ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga pandemia. Qeveria Kurti në programin e vet i ka kushtuar rëndësi sundimit të ligjit, zhvillimit ekonomik, sigurisë publike dhe politikës së jashtme në të cilën përfshihet edhe dialogu me Serbinë. Në këtë kontekst, qeveria do të angazhohet në dialogun me Serbinë me synim normalizimin përfundimtar të marrëdhënieve dypalëshe. Për këtë proces, ku lehtësuese është BE-ja, qeveria synon të koordinohet edhe me ShBA-në dhe opozitën

të sigurohemi që në vazhdimësi të ketë vaksinim të popullatës përkritazi me planin nacional të vaksinimit" është thënë në programin qeverisës të Qeverisë Kurti. Kurse sa i përket aspektit ekonomik, qeveria e drejtuar nga Albin Kurti planifikon t'i ndërmarrë disa masa sidomos në aspektin social. Rritjen e fuqisë blerëse synon ta arrijë nëpërmjet intervenimeve me masa për rritjen e likuiditetit tek amvisëritë dhe me mbështetjen e atyre që kanë nevojë më së shumti për ndihmën shtetërore. Nëpërmjet rritjes së pagës minimale në 250 euro, për 40 orë punë në javë, si dhe ngritjes së pragut të pagës që nuk tashmë në nivelin e pagës minimale, do të bëhet përpjekje që ata që kanë paga më të ulëta, të kenë më shumë para në fund të muajit. Daljen nga pandemia e shohin si mundësi të re për ta riorientuar ekonominë drejt prodhimit e eksportit, drejt rritjes së punësimit të dinjitetshëm për të gjithë, si dhe drejt një zhvillimi të qëndrueshëm, që mbron ambientin edhe për gjeneratat e ardhshme, është thënë në programin qeverisës të ekzekutivit.

Në këtë kontekst, qeveria ka bërë me dije se do të angazhohet për krijimin e Fondit Sovran dhe themelimin e Bankës Zhvillimore të Kosovës. "Fondi Sovran do t'i marrë nën pronësi asetet strategjike të Republikës së Kosovës, për t'i valorizuar ato, për mundësimin e investimeve të jashtme dhe qasjen në tregje të huaja të kapitalit. Po ashtu, Fondi Sovran do ta ketë përgjegjësinë ekskluzive për investimet në rritjen e vlerës së 'Trepçës', KEK-ut, Telekomit dhe Postës. Si pasojë e kësaj, do ta shuajmë Agjencinë Kosovare për Privatizim me anë të transferimit të saj në agjenci brenda qeverisë. Për arrijtjen e prioriteteve zhvillimore të

përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim do ta krijojmë Agjencinë Zhvillimore si një mekanizëm për udhëheqjen e politikave zhvillimore ndërmjet ministrive dhe agjencive të pavarura. Për më tepër, Agjencia do ta mbështesë sektorin privat dhe publik për arrijtjen e synimeve strategjike zhvillimore nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të biznesit vendor, promovimit dhe rritjes së investimeve të jashtme dhe rritjes së eksportit. Po ashtu, do ta themelojmë Bankën Zhvillimore të Kosovës. Banka Zhvillimore do të jetë mekanizëm për mbështetjen e sektorit privat dhe promovimin e investimeve", është thënë në këtë program qeverisës. Qeveria Kurti 2 gjatë mandatit qeverisës synon ta reformojë edhe sistemin shëndetësor. "Një nga prioritetet më të rëndësishme në sistemin shëndetësor është ndryshimi i Ligjit për sigurim shëndetësor dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative njerëzore dhe infrastrukturore në Fondin për Sigurime Shëndetësore, si kushte për fillimin e grumbullimit të kontributeve", është thënë në programin qeverisës të Qeverisë së Kosovës. Po ashtu, qeveria Kurti synon ta ulë varfërinë dhe ta rrisë mirëqenien sociale. "Për këtë qëllim, do t'i rimbursojmë të gjitha familjet që kanë të ardhura të ulëta, varësisht nga të ardhurat vjetore që marrin këto familje. Do ta fillojmë zbatimin e programit të shtesave për fëmijët. Fëmijët nën moshën dy vjeçe do të përfitojnë shtesa mujore në vlerë prej 20 eurove në muaj, ndërsa fëmijët nën moshën 16 vjeçe do të përfitojnë shtesa mujore në vlerë prej 10 eurosh në muaj. Do ta ndryshojmë pushimin e lehonisë dhe atë prindëror në atë mënyrë që të dy prindërit ta kenë këtë mundësi. Për nënat e papuna, do ta paguajmë pagën minimale prej

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 MAJ - Qeveria e Kosovës ka publikuar programin qeverisës 2021-2025, i cili pasqyron orientimet e përgjithshme të qeverisjes sa i përket agjendës së integritetit evropian dhe politikës së jashtme. Ky program, sipas qeverisë Kurti, transmeton frymën demokratike dhe pluraliste të vendit dhe siguron kompletimin e procesit të shtetndërtimit dhe integritetin e plotë të Republikës së Kosovës në kuadër të institucioneve rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare. "Ne synojmë të fokusohemi në dy prioritete themelore dhe më urgjente. Prioriteti i parë është fokusimi në menaxhimin e pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19 me synim të minimizimit të pasojave në shëndetin publik. Prioriteti i dytë është fokusi në lehtësimin e pasojave ekonomike dhe sociale

të shkaktuara nga pandemia, që kërkon mobilizimin e tërë potencialit shtetëror. Po ashtu, do të fokusohemi në luftimin e krimit dhe korrupsionit dhe në transformimin ekonomik e social të vendit, me synim të përfshirjes sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës", është thënë në programin e Qeverisë Kurti. Sa i takon pandemisë, Qeveria e Kosovës synon që gjatë këtij viti të bëjë vaksinimin e 60 për qind të popullsisë. "Në këtë aspekt, duhet të theksohet që nëpërmjet burimeve të ndryshme gjatë vitit 2021 synojmë vaksinimin e 60 për qind të qytetarëve të Kosovës. Sigurimi i kësaj mase do të bëhet në dy drejtime: nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe zotimet e tyre në kuadër të aleancës COVAX, si dhe nëpërmjet angazhimit të Ministrisë së Shëndetësisë, si udhëheqëse e negociatave në nivel të qeverisë, për sigurimin dhe shpërndarjen e vaksinave. Do

forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës përmes integritit e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, përmirësimi i shërbimit të jashtëm, strategjia e lobimit dhe promovimi diplomatik, kulturor dhe ekonomik. "Me një orientim konstant kah shteti ligjor modern evropian, duke u mbështetur fort në fundamentin tonë politik në bashkësinë e demokracive liberale, në bashkëpunim të ngushtë me ShBA-në, dhe me një pozicionim të qartë kundër tendencave dhe shteteve autoritare, Kosova qëndron fort si një partnere e qëndrueshme dhe strategjike në krah të miqve dhe aleatëve në BE, NATO dhe më gjerë", është thënë në programin qeverisës të qeverisë Kurti.

Në këtë aspekt, në këtë program qeverisës përmendet edhe thellimi i bashkëpunimit me Shqipërinë. Qeveria e Kosovës do të angazhohet për një qasje të strukturuar dhe të institucionalizuar të bashkëpunimit dhe integritit ndërshtetëror. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë do të thellohen marrëdhëniet në fusha të ndryshme për t'i jetësuar marrëveshjet e arritura më parë, si: tregtia, financat, arsimit dhe shkenca, siguria, si dhe në veçanti harmonizimi i politikës së jashtme", është thënë në këtë program qeverisës.

Si prioritet të politikës së jashtme të qeverisë Kurti janë edhe reformimi dhe avancimi i diplomacisë. Duke iu referuar programit qeverisës, Qeveria e Republikës së Kosovës është e gatshme ta njohë ndërkombëtarisht Republikën e Serbisë nëse kjo e fundit e njeh Republikën e Kosovës dhe në veprimet dhe deklarimet e saj distancohet nga kërcënimet e Republikës së Kosovës dhe i fqinjëve të tjerë në rajon me ndërhyrje politike dhe retorikë nacionaliste e shpesh edhe raciste. "Me partnerët e saj amerikanë dhe evropianë, Republika e Kosovës do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për ta arritur njohjen e ndërsjellë në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, të mirëmbajë raporte

normale të bazuara në parimin e shëndoshë të reciprocitetit dhe të japë një kontribut të rëndësishëm për paqen, sigurinë dhe stabilizimin afatgjatë të rajonit. Qeveria e Kosovës angazhohet në dialogun me Serbinë me synim normalizimin përfundimtar të marrëdhënieve dypalëshe. Dialogu me Serbinë zhvillohet për adresimin e çështjeve ndërshtetërore dhe fqinjësisë së mirë, dhe ka orientim kryesor përfitimet e qytetarëve nga rezultatet e dialogut ndërshtetëror. Marrëveshja finale e synuar do të ketë brenda të gjitha çështjet e pazgjidhura që nga suksesioni i ish-Federatës Jugosllave në të cilën Kosova ishte element konstitutiv. Marrëveshjet e deritanishme do të trajtohen për ta parë shkallën e përbushjes dhe ndikimin e tyre. Me opozitën do të bashkëbisedojmë rregullisht për të ndërtuar konsensus nacional në përgjithësi sa i përket politikës së jashtme, e në veçanti për raportin me Serbinë. Qeveria e Kosovës do të marrë pjesë në dialogun me Serbinë me parime të qarta dhe me qëllimin që marrëveshja finale, përveç çështjeve ndërshtetërore, do ta përfshijë edhe njohjen reciproke mes shteteve, njohjen nga pesë vendet e mbetura të BE-së si dhe anëtarësimin në OKB", është thënë në programin e qeverisë të publikuar nga Qeveria e Kosovës. Përveç rolit ndërmjetësues të BE-së, Qeveria e Kosovës e sheh si shumë të rëndësishëm edhe koordinimin e ngushtë me ShBA-në. "Qeveria e Kosovës konsideron se pjesëmarrja në dialog duhet të bëhet duke u bazuar në përgatitje të mirëfilltë dhe dakordim të përbashkët për temat që duhet të bisedohen. Për këtë proces do të bashkëpunojmë me partnerët ndërkombëtarë dhe do t'i ftojme të gjitha partitë politike, si dhe do të angazhojmë ekspertë të njohur për të kontribuar në këtë drejtim", është thënë në programin e qeverisë e cila drejtohet nga kryeministri Albin Kurti.

Pas miratimit dhe publikimit të programit qeverisës nga ana e qeverisë, i njëjti do të dalë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës.

Trajtimi i mjedisit dhe planifikimit hapësinor në programin e Qeverisë së Kosovës 2021-2025



Shkruan: Prof. dr. FERAT SHALA, deputet i PDK-së

Në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2021-2025, në kapitullin 2.12 trajtohen edhe çështjet që ndërlidhen me mjedisin dhe planifikimin hapësinor.

Në këtë kapitull, ndër të tjera, flitet për: përmirësimin e cilësisë së ajrit, menaxhimin e integruar të mbeturinave, menaxhimin e ujërave, ngritjen e infrastrukturës ujore, mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, banimin social dhe banimin e përbalueshëm.

Nëse e bëjmë një analizë të shkurtër të përmbajtjes së kësaj pjese të programit, ndër të tjera, do të konstatojmë se:

- Nuk ka objektiva të qarta dhe mirë të definuara për punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këtë sektor për periudhën 2021-2025;
- Ka përsëritje të objektivave dhe aktiviteteve nga programet e qeverive të mëhershme;
- Ka përfshirje të aktiviteteve të mbështetura nga donatorët që tashmë kanë përfunduar

(si, p. sh., lansimi i portalit për cilësi të ajrit);

- Ka aktivitete rutinë që kryhen në mënyrë kontinuale nga departamentet përkatëse të MMPHI dhe që nuk paraqesin ndonjë zhvillim të ri apo zotim të qeverisë (si, p. sh., hartimi i akteve nënligjore, monitorimi i mjedisit apo ngritja e kapaciteteve institucionale);

- Nuk ka zotime të qarta për investime dhe projekte konkrete në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinorë;

- Nuk janë të definuara afatet kohore e as mjetet në dispozicion që do të ndahen për projekte mjedisore;

- Nuk prezantohen metodologji dhe instrumente konkrete që do të përdoren për përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe arritjen e objektivave;

Në shumë raste në këtë pjesë të programit ka edhe ngatërrim të fushave dhe përgjegjësive sikurse janë përfshirja e zotimeve dhe objektivave për inventarin e gazrave serrë dhe ligjit për ndryshime klimatike në kuadër të sektorit të natyrës dhe biodiversitetit, pastaj përfshirja e zotimeve dhe objektivave për ndërtimin e impianteve për trajtim të ujërave të zeza dhe funksionalizimi i puseve për monitorim të ujërave nëntokësore në kuadër të sektorit të mbeturinave, apo edhe zotimet që kanë të bëjnë me shpronësimin dhe kadastrën në kuadër të sektorit të planifikimit

hapësinorë.

Në kuadër të zotimeve dhe objektivave, hasen edhe anomalitë apo mosnjohje e procesit të hartimit të ligjeve sektoriale, sikurse është premtimi për hartimin e një ligji të veçantë për financimin e menaxhimit të resurseve ujore, që është një praktikë jo e zakonshme meqenëse kjo çështje mund të rregullohet me rishikimin e ligjit të ujërave apo edhe me ndonjë akt nënligjor që mund të jetë rregullore apo udhëzime administrativ, por jo një ligj të veçantë.

Nga mënyra e përshkrimit të zotimeve dhe objektivave, kjo pjesë e programit më shumë i ngjan një programi që do të vazhdojë implementimin e aktiviteteve dhe projekteve që tashmë ose janë realizuar, janë në proces të realizimit apo edhe janë iniciuar nga qeveritë e kaluara.

Në asnjë pjesë të programit që i dedikohet mjedisit nuk gjejmë ndonjë zotim, objektiv apo aktivitetë risi apo qasje ndryshe që sjellë kjo qeveri për mbrojtjen e mjedisit por më shumë shohim një vazhdim të punës dhe përpjekjeve të deritanishme që janë bërë në këtë sektor.

Si përfundim nëse bazohemi në këtë që është prezantuar në kapitullin e mjedisit dhe planifikimit hapësinorë ky program i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2021-2025 në formatin e prezantuar, nuk pritet të sjellë ndryshime e as përmirësime të gjendjes së mjedisit.

LDK-ja kritikon programin e qeverisë Kurti

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ka mbajtur të mërkurën një konferencë në lidhje me programin qeverisës të qeverisë Kurti. Deputeti dhe anëtari i kryesisë i LDK-së, Besian Mustafa, e ka konsideruar të zbrazët programin qeverisës për ekonomi. Sipas tij, ky program përmban vetëm premtime boshe. "Për t'u bërë hapja e sektorit privat, edhe vaksinimi duhet të vërehet shpejt. Shumë

fjalë, asnjë masë e shifër. Zhvillimi ekonomik parashih shumë ligje, por pa përmendur masa konkrete. Edhe më keq, nuk ka asnjë fjalë të vetme për buxhetin. Nuk parashihet asnjë projekt i ri kapital për katër vjetët e ardhshëm. Fondi sovran do t'i mbledhë të gjitha pasuritë strategjike në vend. Nuk dihet se si do të menaxhohen këto pasuri të qytetarëve. Shumë fjalë, asnjë masë, asnjë shifër. Pra kush përfiton nga programi zhvillimor do të vendosë një



ekip i ngushtë", ka thënë Mustafa, duke shtuar se qeveria e drejtuar nga Albin Kurti do t'i ngarkojë qytetarët me borxh. "Banka Zhvillimore nuk do ta përkrahë sektorin privat. Në

pjesën e energjisë nuk kanë idenë me këtë sektor. Nuk mund të plotësohen nevojat me energji pa kapacitete të reja. Programi i qeverisë nuk jep përgjigje si do të implementohet. Por shihet që të gjitha do të paguhet duke i futur qytetarët në borxhe. 1.6 miliard euro qeveria do ta rrisë borxhin. Kush do t'i paguajë brezat e ardhshëm. Në vend se të investojë në rini, ka vendosur ta zhytë në borxhe deri në pleqëri", është shprehur Mustafa.

Konjufca dhe Kurti nderojnë heroin Agron Rrahmani në 23-vjetorin e rënies së tij

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti kanë bërë homazhe te varri i heroit Agron Rrahmani në 23-vjetorin e rënies së tij. Me këtë rast, kryeministri Kurti ka thënë se Agron Rrahmani ishte frymëzuar nga heronjtë, që synim kishin çlirimin e vendit dhe bashkimin e kombit. "Agron Rrahmani ra në betejë të drejtpërdrejtë me forcat armike që atëherë ishte veprimtar politik, kurse sot është dëshmor. Agroni, si të gjithë shokët e tij, nuk e duronte padrejtësinë, shtypjen, shfrytëzimin dhe u

angazhua tërë jetën për çlirimin e vendit dhe bashkimin e kombit. Ai është frymëzuar nga veprimtarë që i kanë paraprirë dhe sot është pjesë e lavdishme e historisë sonë e cila përbën edhe themelet e institucioneve tona dhe tregon rrugën se kah ato duhet të vazhdojnë që të zhvillohemi. Historia e kombit tonë përbëhet nga dëshmorët, ndërkaq ardhmëria jonë varet nga besnikëria ndaj tyre", ka thënë ai.

Ndërsa kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se dëshmori Agron Rrahmani i ishte bashkuar UÇK-së menjëherë pas formimit



të saj dhe se vepra e tij do të kujtohet e të nderohet gjithmonë. "Është një prej figurave më të rëndësishme të

ushtisë tonë çlirimtare. Agroni qysh prej rënies së Afrim Zhitisë në vitin 1989 e Fahri Fazliut aty e bëri betimin sepse mësoi prej

heronjve tanë se si duhet të jepet jeta për atdhe kur e kërkon puna. Agron Rrahmani menjëherë sapo kanë filluar strukturat e para të UÇK-së u kyç për ta dhënë kontributin e tij për çlirimin e vendit. Agroni do të kujtohet e nderohet gjithmonë. Agron Rrahmani menjëherë sapo kanë filluar strukturat e para të UÇK-së u kyç për ta dhënë kontributin e tij për çlirimin e vendit. Agroni do të kujtohet e të nderohet gjithmonë", ka thënë Konjufca. Homazhe te varri i heroit Rrahmani kanë bërë edhe përfaqësues nga OVLUÇK-ja.

Deputetët kërkojnë nga drejtori i AKI-së informacione për incidentin në veri dhe 'non-paper'-in

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Petit Ajeti, të mërkurën ka zhvilluar takim njoftues me Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Pas takimit, kryetarja e këtij komisioni, Ganimete Musliu, ka bërë me dije se me drejtorin e AKI-së kanë diskutuar për incidentin e alpinistëve në veri dhe për qarkullimin e një dokumenti i quajtur "non-paper". "Kishim takim njoftues me drejtorin e ri të AKI-së, por gjithsesi pati edhe pyetje që parashtruan unë dhe anëtarët e komisionit. Vlen të ceket se dy nga pyetjet e parashtruara ishin:



informacione rreth incidentit me alpinistët në veri të Mitrovicës dhe, po ashtu, a ka njohuri rreth një sekretit publik që është diskutuar jo vetëm në qarqet e brendshme, por edhe

ato ndërkombëtare, pra 'non-papers' që është diskutuar mjaft", është shprehur ajo, duke bërë me dije se janë pajtuar edhe për një takim të radhës. "E lamë takimin e radhës pas

disa ditësh. Po shpresoj shumë që e kemi filluar mbarë dhe uroj që të kemi bashkëpunim si komision dhe të jemi në krye të detyrës që ta japim maksimumin sa i përket mbikëqyrës dhe kontrollit demokratik të AKI-së. Presim bashkëpunim edhe nga drejtori", ka deklaruar Musliu. Më tutje, Musliu ka thënë se komisioni që drejton ka vendosur që të ftohet për raportim edhe kryeinspektori i AKI-së në mënyrë që të ketë pasqyrim të qartë rreth gjendjes në këtë agjenci. "Në javën e ardhshme morëm vendim që ta ftojme kryeinspektori si zinxhir organizativ që është

brendapërbrenda. Po besoj që pas takimit do ta kemi një pasqyrë të qartë se ku qëndron agjencia dhe pastaj do të shohim se ku qëndrojnë mundësitë tona", ka thënë ajo. Kryetarja e komisionit për mbikëqyrjen e AKI-së, Ganimete Musliu, ka theksuar se është duke u paraparë edhe plotësimndryshimi i Ligjit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. "Jemi në diskutim e sipër që kemi nevojë për plotësiminndryshimin e Ligjit të AKI-së. Do të shohim a është në agjendën e programit qeverisës. Ai (Ajeti) na njoftoi që këto dy çështje e kanë vëmendjen e agjencisë", ka thënë Musliu.

Bislimi takohet me ambasadorin austriak, diskutojnë për proceset integruese dhe dialogun

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger. Ambasadori Weidinger e ka uruar zëvendëskryeministrin Bislimi për detyrën dhe përgjegjësitë e reja. Ai ka theksuar se Austria do të vazhdojë ta mbështesë Qeverinë

e Republikës së Kosovës si dhe popullin e Kosovës në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian. Weidinger veçoi fushën e arsimit të lartë dhe atë të investimeve direkte si pika kryesore të bashkëpunimit mes dy vendeve. Zëvendëskryeministri Bislimi ka shprehur mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që shteti i Austrisë ia ka dhënë Kosovës dhe ka theksuar

vullnetin dhe gatishmërinë për ta shtuar bashkëpunimin edhe në fusha të ndryshme me interes për të dyja vendet. Ambasadori Weidinger dhe zëvendëskryeministri Bislimi kanë diskutuar edhe për situatën me pandeminë Covid-19 në Kosovë, vizitën e kryeministrit Kurti dhe zëvendëskryeministrin Bislimi dhe Gërvalla në Bruksel, si dhe dialogun Kosovë - Serbi.



Haxhiu takohet me përfaqësuesit e Odës së Ndërmjetësuesve

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka takuar të mërkurën përfaqësuesit e Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës, Faton Morina, si dhe kryetaren aktuale të Bordit të Odës së Ndërmjetësuesve, Adelina Isufi. Morina dhe Isufi e kanë informuar ministren lidhur me angazhimet e Odës së



Ndërmjetësuesve që nga themelimi i Odës e deri tek organizimi i seancave të ndërmjetësimit online, që në vitin e fundit kanë kontribuar për zgjidhjen e më shumë se 5 000 rasteve përmes ndërmjetësimit. Po ashtu, ata e kanë njoftuar ministren Haxhiu për nevojën e hartimit të politikave të ndërmjetësimit

që i referohen regjistrimit të ndërmjetësuesve dhe tarifave të tyre ashtu siç është paraparë me Ligjin për Ndërmjetësim. Ndërsa ministria Haxhiu ka shprehur shqetësimet e saj lidhur me vonesën për zbatimin e procedurave ligjore me qëllim të adresimit të obligimeve të parapara me ligj.

Katër të vdekur, 316 të shëruar dhe 113 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit kanë vdekur katër persona dhe

janë raportuar 113 raste të reja të infektimit me koronavirus. Sipas këtij instituti, gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 316 pacientë nga Covidi. "Numri

total i rasteve pozitive është 106 651 raste nga 559 537 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 2 217 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar

316 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 98 539 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5 895", ka njoftuar IKShPK-ja.



Arrijnë në Kosovë edhe 38 400 doza të vaksinës kundër Covidit



Të mërkurën në Kosovë kanë arritur 38 400 doza të vaksinës kundër Covidit. Këto vakcina janë pranuar nga drejtuesit e institucioneve shtetërore. Me këtë rast, IKShPK-ja i ka inkurajuar qytetarët për ta marrë vaksinën kundër Covidit. Sipas IKShPK-së, vaksinimi është mënyra më e mirë, më e lirë dhe më efikase për t'u mbrojtur nga Covidi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Në Kosovë kanë arritur 38 400 doza të vaksinës kundër koronavirusit përmes programit COVAX të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili ka për qëllim shpërndarjen e vaksinave në vendet e varfra. Lajmin e ka konfirmuar Agjencia për Fëmijë e Kombeve të Bashkuara, UNICEF dhe Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. Shpërndarja e vaksinave "AstraZeneca", sipas UNICEF-it, do të bëhet në bazë të planit kombëtar të vaksinimit të Kosovës.

Ky është kontingjenti i dytë i vaksinave që Kosova pranon nga programi COVAX, pasi më 28 mars kishte arritur dërgesa e parë me 24 mijë doza të vaksinës.

Këtë javë dhe javën e kaluar vendi ka pranuar edhe dy kontingjente vaksinash "Pfizer/BioNTech", me mbi 7 000 doza në total, si donacion nga Bashkimi Evropian

(BE).

BE-ja ka ndarë gjithsej 95 000 doza të vaksinave për Kosovën të cilat do të shpërndahen gradualisht. Kontingjenti i ri të vaksinave në kuadër të Aleancës COVAX e kanë pranuar kryeministri Albin Kurti, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ambasadori i Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott, shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ambasadori i Francës dhe i Gjermanisë, drejtori i UNICEF-it, Murat Sahin dhe drejtoresha e Misionit të USAID në Kosovë, Lisa Magno.

Të mërkurën ka filluar vaksinimi i personave mbi 65 vjeç kundër koronavirusit.

Radhë të gjata të qytetarëve janë krijuar te Salla e Sporteve "1 Tetori" në Prishtinë, ku po vazhdon vaksinimi kundër Covid-19. Sipas planit shtetëror, vaksinimi në Kosovë është ndarë në tri faza. Personat 65-79 vjeç bëjnë pjesë në fazën e dytë, ashtu si edhe mësimitdhënësit dhe

forcat e sigurisë, të përfshira në menaxhimin e pandemisë. Në fazën e parë, që ka nisur në fund të marsit, janë vaksinuar punëtorët shëndetësorë, personat mbi 80 vjeç dhe personat me sëmundje kronike. Në fazën e tretë, ndërkaq, pritet të bëhet vaksinimi i 50 për qind të popullsisë së Kosovës.

Programi i UNICEF-it në Kosovë ka bërë me dije edhe një herë se Kosova në fillim të muajit qershor do të furnizohet edhe me 100 mijë e 620 doza të vaksinës kundër Covidit nga COVAX.

IKShPK-ja inkurajon qytetarët ta marrin vaksinën kundër Covidit

Pas pranimit 38 400 dozave të vaksinave, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) i ka inkurajuar qytetarët që ta marrin vaksinën kundër Covidit. Sipas IKShPK-së, vaksinimi është mënyra më e

mirë, më e lirë dhe më efikase për t'u mbrojtur nga Covid-19. "Vaksinat janë një nga ndërhyrjet më të efektshme të shëndetit publik, duke parandaluar 2-3 milionë vdekje në vit. Vakcina ju ndihmon juve dhe familjes tuaj të mbroheni kundër Covid-19. Vaksinimi juaj mbron të tjerët në rrethin tuaj duke ndihmuar parandalimin e përhapjes së sëmundjes tek ata që nuk kanë mundësi ta marrin vaksinën. Derisa sasia e vaksinave është e pamjaftueshme për vaksinimin e 70 për qind të popullatës, është e rëndësishme që së pari të vaksinohen personat që janë në rrezik më të lartë të sëmundjes rëndë ose të vdesin nga Covid-19, si dhe ata që kanë një rrezik të lartë të infektimit me SARS-CoV-2 për shkak të kontaktit me pacientët e infektuar. Shumë vakcina janë aprovuar kundër Covid-19, që janë po kaq të efektshme për mbrojtje individuale kundër Covid-19 dhe si përgjigje ndaj pandemisë", ka

njoftuar IKShPK-ja, duke bërë me dije se Kosova i ka vaksinat ("Astrazenca" dhe "Pfizer") e sigurta dhe efikase. "Vaksinat kundër Covid-19 veprojnë së bashku me mbrojtjen natyrale të trupit tuaj për të krijuar imunitet kundër virusit. Deri tani në Kosovë janë vaksinuar 29 704 persona me dozën e parë dhe asnjë nga ta nuk ka raportuar efekte të rënda pasvaksinale. Vaksinat kundër Covid-19 janë mundësia jonë më e mirë për mposhtjen e pandemisë dhe kthimin në normalitet", ka njoftuar IKShPK-ja.

Më tutje, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka theksuar se Ministria e Shëndetësisë, në koordinim me IKShPK-në, janë duke e zbatuar në përpikëri planin shtetëror të vaksinimit të popullatës kundër Covid-19.

"Ekipet e profesionistëve shëndetësorë janë duke realizuar me një dinamikë të shtuar procesin e vaksinimit, duke zbatuar standardet më të larta profesionale, andaj të gjithë së bashku ta mbështesim punën e tyre në këtë situatë të vështirë të shëndetit publik. Komiteti Kombëtar për Vaksinim kundër COVID-19 u ka dhënë prioritet punëtorëve shëndetësorë si kategori esenciale për menaxhim të situatës me pandeminë, krahas kategorive të tjera që, po ashtu, janë vaksinuar në fazën e parë, si të moshuarit, të vendosurit në qendrat për të moshuar dhe punëtorët socialë që kujdesen për ta, të sëmurët kronikë në moshat e shtyra etj., gjithnjë sipas planit shtetëror të vaksinimit kundër Covid-19. Andaj i inkurajojmë qytetarët që t'i përcjellin njoftimet zyrtare për fazat e ardhshme të vaksinimit dhe kategoritë që do të vaksinohen sipas planit.

PSD-ja, aksion para MSh-së, kërkon dorëheqjen e ministrit Vitia

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Partia Socialdemokrate ka zhvilluar një aksion simbolik para Ministrisë së Shëndetësisë (MSh). Para objektit të ministrisë aktivistë të kësaj partie kanë vendosur një shiringë ku shkruhej "Dorëheqje", duke bërë thirrje që dorëheqje të japë ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia. Dorëheqjen e ministrit Vitia

aktivistët e PSD-së e kanë kërkuar për shkak se, sipas tyre, ai nuk është duke arritur t'i blejë vaksinat kundër Covidit. "Numri i vaksinave që Qeveria e Kosovës ka blerë është zero. Pra bash asnjë vaksinë nuk e kemi të blerë. Prandaj, sot po ia japim ministrit Vitia, apo dr. 'Hipokritit' dozën e parë të vaksinës me ilaçin e dorëheqjes. Kanë thënë që

pandeminë e kanë prioritet mbi prioritetet dhe që deri në fund të vitit do të vaksinohet 60 për qind e popullsisë. Sot jemi dëshmitarë që as vaksinat e fala nuk kanë mundur t'i menaxhojnë si duhet. Tempoja e vaksinimit është tepër e ngadalshme dhe shumë burokratike. Me këtë ritëm nuk ka asnjë gjasë që synimet të arrihen", ka thënë aktivisti i PSD-së, Nol Nushi.



Këshilli protestues i ndërmarrjes 'Trepça' kërkon përkrahje nga Bahtiri

MITROVICË, 12 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur sot në takim këshillin protestues si dhe Rafet Ibishin, ushtrues i detyrës i kryeshefit të ndërmarrjes "Trepça". Në këtë takim është diskutuar për pakënaqësitë e protestuesve lidhur me procesin e fundit të punësimit në kombinatin "Trepça", duke kërkuar sistemimin e tyre në punë.

Këshilli protestues kërkoi nga kryetari Bahtiri mbështetje për adresimin e kërkesës së tyre në instancat më të larta

duke theksuar se ekziston përkrahja nga menaxhmenti aktual i kombinatit "Trepça" dhe nga Sindikata e Punëtorëve të Kombinatis "Trepça", por emëruesi i përbashkët i zgjedhjes së problemit është vullneti i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryetari Bahtiri ka ofruar mbështetjen e tij, duke theksuar që në kuadër të mundësive dhe kompetencave të tij si kryetar i komunës do të angazhohet që këtë kërkesë ta delegojë tek institucionet kompetente.



Lladrovci merr pjesë në inaugurimin e pllakës përkujtimore të Rrahman Nishorit



DRENAS, 12 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, familjarë e shumë qytetarë, kanë marrë pjesë në inaugurimin e pllakës përkujtimore të Rrahman Nishorit, ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në luftë i njohur si "Xhaxhi".

Zbulimi i pllakës

përkujtimore është bërë me rastin e njëvjetorit të vdekjes së tij dhe është ngritur nga familjarët. Me këtë rast, kryetari Lladrovci tha se ndihet i nderuar të marrë pjesë në inaugurimin e kësaj pllake përkujtimore. "Rrahman Nishori-'Xhaxhi' njihej si një veteran i devotshëm i Brigadës 121 të UÇK-së, që me punën, veprat

e angazhimit e tij ka motivuar shumë të rinj e të reja t'i bashkohen luftës së lavdishme", ka thënë kryetari Lladrovci.

Ne emër të shoqatave të dala nga lufta ka folur Xhavit Jashari, ndërsa një evokim kujtimesh për jetën dhe veprën e Rrahman Nishorit e ka paraqitur komandanti i Brigadës 121, Ajet Kastrati.

500 familje në Malishevë ndihmohen për festën e Bajramit

MALISHEVË, 12 MAJ (ER) - Me rastin e festës së Fitër Bajramit, falë donatorëve dhe Komunës së Malishevës, brenda një jave 500 familje janë ndihmuar me miell, pako ushqimore dhe higjienike.

Ndihma për familjet skamnore kanë dhënë humanisti Halim Hoti, shoqata "Jetimat e Ballkanit", shoqata "Duart e Bamirësisë" dhe humanisti Elvis Naçi,

Komuna e Malishevës dhe të gjitha këtyre pakove, komuna u ka shtuar edhe miell.

Drejtori për Emergjencë në Komunën e Malishevës, Hafir Rexha, në emër të Komunës së Malishevës i ka falënderuar të gjithë këta donatorë për përkrahjen e vazhdueshme për familjet në nevojë në Komunën e Malishevës.

Koordinatori komunal për shpërndarjen e këtyre

ndihmave, Halit Mazreku, ka bërë me dije se të gjitha këtyre ndihmave komuna u ka shtuar edhe miell, duke u kompletuar pakot ushqimore, ndërsa shpërndarja e tyre është bërë nga komuna në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave, në mënyrë që të shmanget tollovia, kurse përfitues janë familjet me gjendje më të rëndë sociale.



Themelohet Biblioteka në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Ferizaj



FERIZAJ, 12 MAJ (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka pranuar në formë donacioni nga OSBE-ja tetëdhjetë e nëntë (89) tituj të librave shkencorë. Librat e dhuruara janë nga fusha e të drejtës penale, administrative, nga fusha e të drejtave të njeriut, e drejta sociale, e drejta kushtetuese dhe kriminalistika në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Gjithashtu janë dhuruar edhe disa tituj nga lëmi policor për lidhshmëri dhe udhëheqje. Me këtë rast, është themeluar biblioteka në

Drejtorinë Rajonale të Policisë në Ferizaj dhe planifikohet që të pasurohet edhe me tituj të tjerë, duke bashkëpunuar me komunat e rajonit tonë, biblioteka, librari, shtypshkronja, por edhe me autorë të ndryshëm.

Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka falënderuar OSBE-në për përkrahjen e vazhdueshme që ka për policinë tonë, e sidomos për donacionet e dhuruara me qëllim të ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve policore.

FKGK-ja nënshkruan marrëveshje me dy institucione mikrofinanciare

PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Në ambientet e Fondit Kosovor për Garanci Kreditorë (FKGK), dy institucionet mikrofinanciare më të mëdha për sa i përket vëllimit të kredive aktive, "KEP Trust" dhe "FINCA Kosovë", kanë nënshkruar marrëveshjet e garancisë për garantimin e kredive bujqësore brenda "Dritares Agro" të FKGK-së. Kjo ngjarje shënon një çast kyç për FKGK-në dhe për sektorin mikrofinanciar, duke ofruar garanci për kredi bujqësore për fermerët dhe agrobizneset vendore. Arsim Bruçaj, drejtor ekzekutiv në Asociacionin e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AMIK), ka theksuar se nënshkrimi i marrëveshjes së institucioneve mikrofinanciare me FKGK-në do të jetë një shtysë e madhe në rritjen e kreditimit për bujqit dhe fermerët e Kosovës dhe është një hap domethënës drejt rritjes së përfshirjes financiare në vendin tonë.

Ndërsa Kastriot Këpuska, agroekspert në FKGK, ka theksuar se ky është një hap i rëndësishëm për të gjitha palët e ndërlidhura drejt përfshirjes dhe garantimit të një baze më të gjerë të klientëve të financiar. Fermerët e financiar nga institucionet mikrofinanciare paraqesin një pjesë të rëndësishme të sektorit bujqësor dhe garantimi i kredive të tyre pritet që ta lehtësojë kredidhënien dhe të ndikojë dukshëm në krijimin e kushteve sa më të mira për financimin e tyre. "Dritarja Agro" është skemë garantuese që operon në kuadër të FKGK-së me qëllim të mbështetjes së fermerëve dhe agrobizneseve duke garantuar kreditë për këtë sektor. Kapitali i përgjithshëm i "Dritares Agro" është në vlerë totale prej 11.5 milionë eurosh dhe është financiar plotësisht nga Qeveria e Gjermanisë përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW).



Rritet konsumi i energjisë elektrike në Kosovë



PRISHTINË, 12 MAJ (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Bilancin i Energjisë në Kosovë" për TM1 2021. Në këtë publikim janë paraqitur të dhënat mbi prodhimin e thëngjillit, të dhënat për prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë. "Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 (TM1 2021) vlera e gjithmbarshme e prodhimit të thëngjillit ishte rreth 2.02 milionë tonë, kurse sasia bruto e energjisë elektrike, e prodhuar në termocentrale, ishte 1 655.1 GWh dhe në

hydrocentrale ishte rreth 85.6 GWh. Sa iu përket vlerave të energjisë së importuar, respektivisht të eksportuar, gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 Kosova ka importuar 918.3 GWh energji elektrike derisa gjatë të njëjtës periudhë, pra TM1 2021, Kosova ka eksportuar 422.6 GWh energji elektrike", është thënë në njoftimin e ASK-së. Sipas këtij njoftimi, në TM1 2021 sasia e energjisë elektrike për konsum ishte 1 510.6 GWh energji elektrike. Në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM1 2020), sasia e energjisë elektrike e konsumuar është rritur për 13.52 për qind.

Rreth 350 minatorë nuk shkojnë në punë, duan pagat

PRISHTINË, 12 MAJ - Më shumë se 350 minatorë të Stantërgut të mërkurën nuk kanë punuar në ndërrimin e parë në shenjë proteste për një pjesë të pagës që s'e kanë marrë ende. Kryetari i Sindikatës "Trepça" me flotacion në Stantërg, Gani Osmani, ka thënë se nuk dihet saktë arsyeja pse ka mbetur pa dalë kjo pjesë e pagës, por se kjo është e papranueshme të ndodhë para festës së Bajramit. "Nuk e dimë saktë pse ka ndodhur, sepse sasia e prodhuar e koncentratit është

shitur. Nga data 7-10 maj është dashur t'i marrim pagat për muajin e kaluar. Përveç festës së Bajramit, ne kemi edhe obligime ndaj bankave, sepse pothuajse të gjithë punëtorët janë në kredi. Janë afërsisht mbi 350 punëtorë të ndërrimit të parë të cilët janë kthyer nëpër shtëpitë e tyre dhe janë të vendosur që mos të kthehen në punë pa i marrë pagat", ka thënë ai. Osmani ka thënë se në çastin që del pjesa e mbetur e pagës rikthehen në punë.



Strategjia e shërbimit sekret serb për ta shkatërruar strukturën e UÇK-së pas vitit 2000 e këndeje (3)



Faton B. MEHMETAJ

Bazuar në disa shifra që janë bërë edhe publike, diku 700 persona nga Kosova janë pjesë e shërbimeve sekrete serbe dhe të sigurisë, përfshirë këtu edhe serbët e Kosovës që janë të rekrutuar nga shërbimet sekrete serbe zyrtarisht. Prej tyre, sigurisht që ka edhe të tillë që punojnë në administratën e Kosovës, madje edhe në pozita të mëdha shtetërore. Një numër jo i vogël që kanë punuar në administratën e qeverisë së Millosheviqit punojnë edhe në administratën e Kosovës, në pozita të lakmueshme. Sigurisht ndokush prej tyre që punon për shërbimet sekrete serbe këtë punë e kryen me komoditet, i mbrojtur nga shteti i ri i Kosovës, konkretisht nga njerëzit e shërbimeve serbe që janë pjesë e institucioneve të Kosovës. E di që ka qenë kërkesë parlamentare e komisionit parlamentar për mbikëqyrjen e AKI-së që të merren iniciativa për t'i zbardhur këto raste, por kjo kërkesë është neglizhuar vazhdimisht edhe nga EULEX-i, KFOR-i dhe shërbimet e sigurisë së Kosovës. Lidhur me këtë, një gjë është vërtetuar, inkorporimi i këtyre strukturave nëpër institucionet e Kosovës e ka shkatërruar progresin dhe zhvillimin e vendit, për shkak se ata e sabotojnë dhe neglizhojnë çdo gjë që lidhet me progresin e Kosovës. Puna e shërbimeve sekrete serbe kundër strukturës së UÇK-së, me kalimin e kohës filloj të japë rezultate, dezinformatat që i lansonte rrjeti i BIA-s dhe bashkëpunëtorëve të tyre kundër UÇK-së u bënë pjesë e vetëdijes sonë të përditshme. Goditjet e pareshtura të shërbimit sekret serb mbi shtresën e UÇK-së arritën që gradualisht ta bëjnë neutralizimin politik të tyre në politik bërjen e Kosovës. Gradualisht strukturat e njerëzve anti-UÇK filluan të rriten dhe të dalin hapur me shpërfaqjet e tyre, shpesh herë edhe pa të vetmen arsye. Gati të njëjtat struktura që sot trumbetojnë kundër UÇK-së, trumbetonin më herët idetë e Millosheviqit se me suprimimin e autonomisë së Kosovës dhe Kushtetutës së Kosovës nuk humb asgjë populli i Kosovës. Në këto kohëra u dënuan mbi 380 persona në ushtrinë jugosllave vetëm pse

ishin shqiptar. Përmes këtyre presioneve por edhe metodave tjera represive Beogradi pretendonte që ti zhvishte shqiptarët prej ç'do lloj pushteti, para aprovimit të kushtetutës së re të Serbisë. Akuzat ndaj shqiptarëve nuk pushuan, kështu ndodhi edhe më rastin e akuzave të "Shtëpisë së Verdhë" në malet e Kukësit, si një "poliklinikë" në të cilën gjoja janë kryer transplantime të organeve njerëzore. Ky trillim për herë të parë u lansua nga Carla Del Ponte, në librin e saj autobiografik me titull "Gjuetia-Unë dhe Kriminelët e Luftës". Këto akuza ishin projektuar fillimisht në laboratorët e shërbimit sekret serb për ta goditur UÇK-n, gjithmonë sipas planit të shërbimeve serbe. Këtë të dhënë e vërteton edhe Ish-bashkëpunëtorja e ngushtë e Del Pontes, Geoffrey Nice. Ajo ka cekur në dëshmitë e saj se Carla Del Ponte krye në vete i ka ngritur aktakuzat kundër shqiptarëve. "Këtë nuk e ka bërë pse ka pasur fakte, por për të tërhequr paralele për barazimin e krimeve, për t'ia bërë qejfin Serbisë apo "për të mos iu hidhëruar Millosheviqit". Dhe për këtë i ka pasur duart e lira, pa mbikëqyrje as nga Haga as nga Nju Jorku. "Carla Del Ponte ka ndihmuar për t'i fshehur implikimet e shtetit serb në krimet e luftës. Punën e saj nuk e ka kontrolluar askush, as në Hagë as në Nju Jork, që është diçka e paimagjinueshme për drejtësinë ndërkombëtare", ka thënë ish-prokurori Nice. Kështu ndodhi edhe me akuzat e ngritura rreth "Shtëpisë së Verdhë", Florence Hartmann, po ashtu ish-bashkëpunëtorja e afërt e Del Pontes, kishte cekur se, në atë kohë, me akuzat që nuk u argumentuan kurrë të cilat i kishte bërë ish-kryeprokurorja e dështuar e Tribunalit të Hagës, Carla Del Ponte, se shqiptarët e Kosovës kanë nxjerrë dhe trafikuar organet e serbëve gjatë luftës në Kosovë, Florence Hartmann i ka quajtur "të papërgjegjshme dhe jodinjitose". "Del Ponte nuk ka as provën më të vogël për një trafik të mundshëm organesh që u janë marrë të burgosurve nga luftëtarët e Kosovës. Ajo po na zhyt sot në orët më të errëta të propagandës", ka nënvizuar Hartmann, për gazetën zvicerane "Le Temps", të datës 16 prill 2008. Të dhënat e paraqitura në këtë libër ishin krejtësisht absurde dhe dukeshin hapur që kishin vetëm një qëllim, njollosjen e strukturës së UÇK-s në arenën ndërkombëtare që serbët e arritën përmes Carla Del Pontes. Madje ajo në një intervistë të dhënë më herët për "Ora News", vë në pikëpyetje edhe ekzistencën e


Kosovës si shtet, që është edhe një sinjal apo dëshmi tjetër që ajo e përfillë dhe është e ndikuar nga politika e qarqeve serbe dhe është lobiste e paguar e nomenklaturës së vjetër të patriotëve serb. Disa vite pas, në mënyrë krejt klandestine, bashkëkombësi i Del Pontes, Dick Marty hartoi një raport me të cilin denoncoi UÇK-në për "transplantim" dhe "trafikim organesh njerëzore" në Këshillin Evropian që rezultoi me themelimin e Gjykatës Speciale me një fond prej 350 milionë dollarësh. Gjykata Speciale u formua për pjesëtarët e UÇK-së mbi bazën e "Shtëpisë së Verdhë", akuzë kjo që ra pasi u arrit qëllimi ndaj UÇK-së, por u harruan mbi 3000 autoritete komanduese ushtarako-policore serbe që kanë kryer krime në Kosovë. Prej këtyre 1000 kanë qenë në pozita të larta komanduese si gjeneralë, kolonelë, majorë etj. Këto të dhëna janë të konfirmuara edhe nga Natasha Kandiçi. Këtu duhet përmendur dëshmitë e Ushtarakut norvegjez Josef Martinsen, autor i dy librave për luftën në Kosovë ("Puset e Vdekjes" dhe "Çka ngjau në Kosovë, 1998-1999"), që menjëherë pas luftës në kuadër të misionit ndërkombëtar (UNMIK) ka asistuar në projektin e nxjerrjes së kufomave të shqiptarëve nga pusët (bunarët). Ai është njëri nga ata që dëshmon me fakte se Serbia kreu gjenocid në Kosovë, por UNMIK-u, arriti t'ia heqë këtë njollë Serbisë, duke i fshehur gjurmët e krimeve masive dhe individuale ndaj shqiptarëve. Shumë prova u fshehën dhe u pengua grumbullimi i të tjerave nga UNMIK-u. Ai deklaroi se shqiptarët nga dikur viktima, propaganda serbe dhe ajo e UNMIK-ut, ndikuan që Perëndimi të fillojë t'i shohë shqiptarët si viktimizues e serbët si viktima. Skenari kryesor u realizua nga UNMIK-u nëpërmjet

fshehjes së provave të gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve. Dhe për këtë askush nuk kërkoi llogari deri më sot. Dihet botërisht se gjatë tërë kohës së pasluftës në Kosovë, administrata ndërkombëtare ka imponuar "një ligj të pashkruar", për minimizimin dhe mohimin e krimeve serbe mbi shqiptarët. Madje ajo ka shkruar edhe më larg, duke i përdorur të gjitha mjetet për t'i shkatërruar dëshmitë që do të argumentonin gjenocidin serb në Kosovë. Me kalimin e kohës dhe pas hetimit të Tribunalit të Hagës, UNMIK-ut dhe EULEX-it, në pamundësi për të gjetur prova e fakte, madje të gjithë këta bashkë nuk kanë mundur ta sigurojnë një provë të vetme, sepse i gjithë rasti ishte trillim i romanit të Carla Del Pontes, "Gjuetia-Unë dhe Kriminelët e Luftës", rasti u mbyll, por që nga viti 2004 e deri në vitin 2010, ky rast edhe pse i rrem dhe i trilluar kishte ndikuar shumë negativisht në imazhin e shtetësisë së Kosovës, sepse mbi këto akuza ishin bërë mijëra shkrime, qindra reportazhe, raporte në Këshillin e Sigurimit, hetime të dhjetëra e dhjetëra rasteve e njerëzve që janë imagjinuar të kenë lidhje me këtë rast. Edhe pse kjo akuzë u devalvua dhe si e tillë u hodh në koshin e mbeturinave, dëmet Kosovës iu bënë të mëdha. Serbia përmes kësaj akuze e zhvendosi vëmendjen e krimeve të luftës mbi strukturën e UÇK-së, duke e amnistuar veten për krimet e tmerrshme që ajo i kishte kryer në Kosovë dhe territorin e ish-Jugosllavisë. Pos kësaj, përmes kësaj akuze, Serbia e zhvendosi edhe vëmendjen e akuzave për transplant të organeve në spitalet e VMA-s që ishin bërë në spitalet ushtarake të Serbisë në një "Shtëpi" të imagjinuar, në "Shtëpinë e Verdhë" në Shqipëri. Përmes kësaj historie krejtësisht imagjinare nga dy zyrtar të lartë evropian, Del Pontes, drejtuese e

Tribunalit Ndërkombëtar të Hagës dhe Dick Marty, senatorit zviceran, i përdorën pozitat e tyre zyrtare për interesa të Serbisë të ndikuar nga diplomacia dhe shërbimet sekrete serbe, arritën ta njollosi strukturën e UÇK-së në nivelin ndërkombëtar me qëllim të shkatërrimit dhe zbehjes së imazhit të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në këtë projekt ishte i përfshirë edhe zyrtari i OKB-së, peruani Jose-Pablo Baraybar, i cili ka udhëhequr shumë kërkime në Kosovë, është paditur nga familjarë të viktimave në Kosovës për eksperimentimin pa autorizim të mbetjeve mortore të mbi 400 viktimave të luftës. Kallëzimi penal ndaj tij është ngritur në vitin 2006 por UNMIK-u nuk jep asnjë detaj për këtë situatë as sot. Përmes këtyre akuzave Serbia arriti qëllimet e veta, duke i vënë në lajthitje dy njerëz më kredibilitet ndërkombëtar. Ky është një tregues i qartë se Kosova u çlirua nga terrori i luftës konvencionale serbe në qershor të vitit 1999, me luftën e UÇK-së dhe mbështetjen e NATO-s, por nuk u çlirua nga terrori i luftës speciale të shërbimeve inteligjente të BIA-së dhe KOS-it. Ata në këtë luftë të ndyrë kundër UÇK-së, paguan shumë media vendore, rajonale e ndërkombëtare, organizuan një fushatë të tmerrshme kundër UÇK-së duke i shfrytëzuar mjetet e komunikimit masiv, librat e shumta, kinematografinë dhe diplomacinë, duke e bërë për vete edhe një pjesë të opinionit të brendshëm në Kosovë, arritën që ta ngujojnë dhe ta kryqëzojnë Kosovën në arenën ndërkombëtare. Gjatë gjithë kohës, deri më sot, shërbimet sekrete serb nuk e kanë ndalur punën e vet për asnjë çast në luftë për ta njollosur, komprometuar e shkatërruar strukturën e UÇK-së.

(Vijon)





Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfën", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8




Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Llapi rrëmben Kupën dhe siguron daljen në Evropë



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

Prishtinë, 12 maj - Skuadra e Llapit është shpallur fituese e Kupës së Kosovës në futboll, pasi e mposhti Dukagjinin e Klinës, pas ekzekutimit të penalltive me rezultat 4-3. "Mendoj që është një emocion i madh, shumë gjenerata kanë sakrifikuar që ne ta arrijmë këtë gjë. Trimat i përcjell fati, unë nuk jam dorëzuar asnjëherë. Sot bashkë me ne do të zbret edhe legjenda Fadil Vokrri, sepse meritat e tij janë të mëdha që ne luajmë sot këtu. Kam luftuar gjithmonë, rinia duhet të marrin mësim nga unë. Arrita që ta shkruaj historinë me këtë skuadër", ka thënë Tahir Batatina, trajneri i Llapit. Koha e rregull nuk solli gola në ndeshjen e

zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri". Prandaj është dashur të zhvillohen edhe vazhdimet, kur në minutën e 113-të, Altin Merlaku realizoi golin e parë duke e kaluar edhe portierin kundërshtar. Llapi i drejtuar nga trajneri Tahir Batatina nuk o dorëzua dhe arriti të barazon rezultatin në minutën e fundit shtesë nëpërmjet Prenqit. Fituesi është dashur të vendoset në penallti ku me e suksesshme doli skuadra e Llapit që fitoi me rezultat 4-3. Ky është një sukses i jashtëzakonshëm për klubin nga Podujeva që gara në Superligë, pasi e fitoi Kupën për herë të parë në histori të klubit. Ndërsa Dukagjinit do t'i mbetet të kërkojë Kupën në edicionet e ardhshme. "Normalisht se është ndjenjë e hidhur. Ishim shumë afër të triumfimit. Jam i lumtur për

djemtë, sepse me të vërtetë luajtën ashtu siç jemi marrë vesh. Por unë kam rezervat e mia për referim. Llapi i Superligës dhe Dukagjini i Ligës së Parë janë njësoj. Por, nuk e kemi pasur tretmanin e njëjtë. Gjyqtarin Nuza e kam mik, e respektoj, edhe është më i miri në Kosovë. Por, sot i kam rezervat e mia. Jemi të zhgënjyer që tifozët nuk kanë qenë të pranishëm, por e kemi ndjerë praninë e tyre gjatë tërë kohës, gjithmonë kanë qenë afër djemve. Penalltitë janë me fat. Jam i lumtur sepse luftuam dhe treguam se nuk është dallimi shumë i madh me skuadrën e Dukagjinit", ka thënë Armend Dallku, trajneri i Dukagjinit. Siç dihet fituesi i Kupës siguron pjesëmarrjen në garat evropiane, përkatësisht në Ligën e Konferencës.

SHKURT

Vushtrria, kampione e Ligës së Parë

Vushtrria është shpallur kampione e Ligës së Parë në konkurrencën e femrave. Skuadra vushtrriase në finalen e tretë të "play-off"-it ka shënuar fitore ndaj United Basketballit me shifrat 66:62. Ndeshjen e parë e kishte fituar skuadra nga Gjilani 85:64, kurse sfidën e dytë skuadra vushtrriase 70:62, pas vazhdimëve. Vushtrria në gjysmëfinale kishte mundur AA Kerasan Prishtinën, kurse United Basketball kishte eliminuar Junior 06. Kupën skuadrës fituese ua dorëzoi Komisari i Garave i FBK-së, Faton Kurshumlija. Vushtrria edicionin e ardhshëm do të luajë në EBC Ligën e Femrave, ku e pret një garë shumë interesante.

Krasniqi, pas ftesës nga Malajzia: E realizova ëndrrën

Liridon Krasniqi ka thënë se ëndrra e tij për ta përfaqësuar Malajzinë po bëhet realitet. Futbollisti nga Kosova u ftua nga ekipi kombëtar i Malajzisë për tri ndeshjet e fundit kualifikuese të Botërorit 2022. "Vetëm desha ta ndaj me ju ëndrrën e cila u bë realitet sot. Që kur e nisa karrierën time në Malajzi, ka qenë ëndërr që ta përfaqësoja vendin që i dha formë karrierës sime profesionale si futbollist në vitet e fundit. Ta marr ftesën e parë për kualifikimet e Botërorit nga ekipi kombëtar i Malajzisë definitivisht më jep krenari dhe gëzim dhe jam i përlulur dhe falënderues për mundësinë që më është dhënë ta përfaqësoj Malajzinë me të gjitha mundësitë dhe aftësitë e mia në arenën ndërkombëtare. Dëshiroj ta falënderoj Zotin, bashkëlojtarët dhe trajnerët", ka shkruar 29-vjeçari në rrjetet sociale.

UEFA nis hetim disiplinor ndaj Realit, Joves dhe Barçës

UEFA ka njoftuar së fundmi se është hapur zyrtarisht një hetim disiplinor për Realin e Madridit, Barcelonës dhe Juventusit. Gjithçka lidhet me krijimin e Super Ligës nga këto klube që tashmë rrezikojnë shumë. Nëpërmjet komunikatës, UEFA njofton se është ngritur një grup inspektorësh për hetimin ndaj tri klubeve të sipërpërmendura. "Në përputhje me nenin 31 (4) të Rregullores Disiplinore të UEFA-s, inspektorët disiplinorë dhe etikë të UEFA-s janë udhëzuar sot të kryejnë një hetim disiplinor për një shkelje të mundshme të kornizës ligjore të UEFA-s nga Real Madrid CF, FC Barcelona dhe Juventus FC në lidhje me i ashtuquajturin projekt 'Super League'. Informacione të mëtejshme mbi këtë temë do të bëhen të disponueshme në kohën e duhur", shkruan UEFA.

Zeka operohet me sukses, rikthehet pas 6 javësh

SUHAREKË, 12 MAJ - Skuadra e Ballkanit ka njoftuar se sulmuesi Mevlan Zeka është operuar me sukses. Rikthimi i Zekës në fushën e blertë do të ndodhë pas gjashtë javësh. "Mevlan Zeka ka përfunduar me sukses operimin në

krahun e majtë. Lëndimin e pësoi gjatë ndeshjes me KF Arbërinë ku doli lëndim serioz. Pritet të rikthehet pas gjashtë javësh në fushën e gjelbër. Shërim të shpejtë, Zeka", ka njoftuar Klubi i Ballkanit. Pas operimit, Zeka në

profilin e vet në "Facebook" ka shkruar: "Vuajtja më mësoi të luftoj, lëndimi më mësoi të mos dorëzohem, dhimbja më mësoi të jem i fortë dhe dashuria e njerëzve të mirë më mësoi të vazhdoj".



Guardiola: Titulli më i vështirë, jam krenar për ekipin tim

MANCHESTER, 12 MAJ - Manchester City është zyrtarisht ekipi kampion i Premierë Ligës. Fitorja 1-2 e Leicester Cityt në "Old Trafford" kundër Manchester Unitedit, shpalli matematikisht ekipin e Pep Guardiols kampion tri javë

përpara fundit të sezonit. Titulli i shtatë në historinë e "Cityzens" dhe i treti me Guardiolen. "Ky ka qenë sezoni më i vështirë, kampionati më i vështirë që kemi fituar deri tani. Do ta mbajmë mend gjithmonë mënyrën se si e fituan këtë

titull. Jam shumë krenar për këtë grup lojtarësh, të gjithë janë të veçantë", ka thënë Guardiola. "Djemtë shfaqën një vazhdimësi të jashtëzakonshme, pavarësisht prej vështirësive të shumta që kemi kaluar. Ky triumf është, gjithashtu, për çdo anëtar të

stafit tonë teknik, i cili ka punuar pa u lodhur në prapaskenë për t'u siguruar që lojtarëve të mos u mungonte asgjë. Premierë Liga është trofeu më i rëndësishëm për të gjithë ne. Kur luan çdo tri ditë, duhet ta tregosh çdo javë që je skuadra më e mirë nëse



dëshiron ta fitosh kampionatin", ka shtuar trajner spanjoll.

Fitojnë lakersat e clippersat, Bostoni dështon ndaj Miamit

BOSTON, 12 MAJ - Miami Heat fitoi sfidën direkte ndaj Boston Celticsit për vendin e 6-të në Konferencën e Lindjes duke siguruar pjesëmarrjen në fazën e dytë të "play-off"-it. Një sukses i merituar i Heatsit me rezultatin 129-121, në një ndeshje deri diku të balancuar, me përjashtim të periodes së dytë dhe të 3-të ku Miami ishte më lart. Herro me 24 pikë, 11 rebounde dhe 3 asistime ishte më i miri mbi parket për skuadrën nga Florida, ndërkohë që Bostonit nuk i mjaftuan 36 pikët e realizuara nga Kemba Walker dhe 33 të tjera nga Jason Tatum. Moment pozitiv për Los Angeles



Lakersin që regjistroi suksesin e dytë rresht, po për momentin vazhdon të pozicionohet në vendin e 7-të në Perëndim dhe duhet të luftojë fort me Portlandin për vendin e gjashtë që të kualifikohet direkt në fazën e dytë të "play-off"-it. Kampionët në fuqi të NBA-s mposhtën, pas kohës shtesë, me rezultatin 101-99, New York Knicksin, duke regjistruar fitoren e 39-të sezonale në 69 takime. Kyle Kuzma me 23 pikë dhe Anthony Davis me 20 pikë ishin dy më të mirët mbi parket për lakersat, ndërkohë që te Knciksi spikatën Julius Randle me 31 pikë dhe Derrick

Rose me 27 pikë. Brooklyn Netsi ndali ecurinë pozitive të Chicago Bullsit prej tri fitoresh rresht falë suksesit 115-107 brenda në Illinois. As Zac Lavine me 41 pikët e tij nuk arriti t'i udhëhiqte bullsat drejt fitores së radhës, ndërkohë që Brooklynit një dorë në këtë sukses ia dhanë Duranti, Harrisi dhe Browni. Blindoi vendin e tretë në Perëndim, ndërkohë Los Angeles Clippersit që triumfoi në "Amalie Arena" ndaj Toronto Raptorsit me rezultatin 115-96. Kawhi Leonard dhe Mann me nga 20 pikë si dhe Zubaq me 18 pikë ishin basketbollistët që udhëhoqën Clippersin drejt këtij suksesi.

REZULTATET

CHARLOTTE - DENVER	112-117
DETROIT - MINNESOTA	100-119
BOSTON - MIAMI	121-129
TORONTO - CLIPPERS	96-115
CHICAGO - BROOKLYN	107-115
INDIANA - PHILADELPHIA	103-94
MEMPHIS - DALLAS	133-104
MILWAUKEE - ORLANDO	114-102
GOLDEN STATE - PHOENIX	122-116
LAKERS - NEW YORK	101-99
SACRAMENTO - OKLAHOMA	122-106

Nadali në dyshim për Olimpiadën, shkak frika nga pandemia

TOKIO, 12 MAJ - Numri dy në botë, Rafael Nadal, ka hedhur dyshime në lidhje me praninë e tij në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" që zhvillohen në Japoni, duke nisur nga 23 korriku. Tenisti spanjoll deklaroi se është i pavendosur për shkak të pandemisë Covid-19 që është ende kërcënuese në botë e veçanërisht në Japoni, ku infektimet janë në nivele të larta. Nadali është "trembur" edhe nga deklaratat e tenistëve vendës, Naomi Osaka e Kei Nishikori, që janë shprehur të pasigurt për zhvillimin e Olimpiadës. Spanjollit ende nuk ka asnjë plan për sa i përket Olimpiadës. "Ende nuk e di nëse do të shkoj apo jo. Sinqerisht, nuk mund të jap një përgjigje, pasi ende nuk e kam vendosur.



Kalendari im i eventeve deri në atë datë është i paqartë për shkak të pandemisë", ka thënë Nadal. "Në një botë normale, përgjigjja ime do të ishte po. Të gjithë e dinë rëndësinë e këtij eventit, se sa e rëndësishme ka qenë për mua

pjesëmarrja në Olimpiadë. Por, në kishte të tilla, nuk e di. Le të shohim se si do të shkojnë gjërat muajt në vijim dhe nëse do të kem hapësira në kalendarin tim dhe a do të jem në 100 % në formë", ka shtuar Nadali.

SHKURT

Neymari 'tradhton' Messin, thërret Ronaldon në Paris

Gjithnjë e më shumë po flitet për një lamtumirë të parakohshme të Cristiano Ronaldos nga Juventusit. Sulmuesi portugez është i dashuruar pas Ligës së Kampionëve, i vetmi trofe që mund ta dërgojë sërish te "Topi i Artë", për këtë arsye prania në Ligën e Kampionëve është një kusht i rëndësishëm për ta respektuar kontratën që ka me "Zonjën e Vjetër". Nëse Juve nuk arrin ta kapë vendin e katërt në Serinë A, Ronaldo mund të largohet, por ku mund të shkojë? Nga Parisi është Neymari që e thërret të bashkohet me të te PSG-ja. "Më cilin lojtar do të kisha dëshira të luaja? Dua të luaj me Cristiano Ronaldon", u shpreh braziliani në një intervistë për "GQ", duke shtuar: "Kam luajtur me lojtarë të mëdhenj si Messi dhe Mbappe, por nuk kam luajtur ende përkrah Ronaldos".

Van Dijku nuk luan në Kampionatin Evropian

Tashmë është zyrtarë, Virgil Van Dijk nuk do të jetë me Holandën në Evropian. Ka qenë vetë mbrojtësi i Liverpoolit i cili është shprehur se nuk do të grumbullohet me kombëtaren e tij, për ta vazhduar rikuperimin nga dëmtimi i cili e ka mbajtur jashtë fushave gjatë gjithë sezonit. "Të mos shkoj në Evropian është zgjedhja më e mirë, duke parë situatën në të cilën ndodhem. Faza e fundit e rikuperimit tim do të jetë në fazën verore me skuadrën. I gjithë përqendrimi im do të jetë te rikuperimi nga dëmtimi. Jam në rrugën e duhur dhe do të vazhdoj kështu. Në stërvitje do të jem përsëri me të rinjtë", ka thënë Van Dijk.

Sportingu shpallet kampion i Portugalisë pas 19 vjetëve

Sporting Lisbona është shpallur kampion pas fitores së fituar 1-0 ndaj Boavistas në kuadër të Ligës së Portugalisë. Këtë sezon, Sportingu ishin të pandalshëm duke fituar kampionatin pa asnjë humbje të vetme. Kjo është hera e parë që skuadra fiton këtë trofe që nga viti 2002. Edhe pse lojtarët e tyre kryesorë vazhduan të largohen ndër vite nga ta, në fund Sportingu arriti që ta fitojë titullin e kampionit. Gjatë tërë kampionatit ata kanë pranuar vetëm 15 gola dhe ky është titulli i 19-të në histori të klubit sa i përket ligës portugeze.

Koeman: Askush nuk mund të fajësohet individualisht

Barcelona ka dështuar që ta marrë kreun e tabelës në La Liga, pasi barazoi 3-3 ndaj Levantes. Trajneri Ronald Koeman ka thënë se i gjithë ekipi nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar dhe se askush nuk mund të akuzohet në mënyrë individuale. "Askush nuk mund të fajësohet individualisht. Ishte i gjithë ekipi që nuk ka qenë në nivelin e tyre për sa i përket mbrojtjes. Pranimi i tre golave për 45 minuta është shumë për këtë ekip. Duhet të vazhdojmë, të përgatitemi për dy ndeshjet e ardhshme dhe sezonin e ardhshëm. Por, së pari, duhet të reflektojmë në takimin që humbëm", ka deklaruar Koeman.



Përfundon sezoni për Ibrën

Sulmuesi Zlatan Ibrahimović nuk mund të luajë për Milanin më në këtë sezon për shkak të lëndimit të gjurit, por pritet të riaftësohet në kohë për Kampionatin Evropian 2020. Sulmuesi 39-vjeçar e

pësoi një lëndim në gju në fitoren e Milanit 3-0 kundër Juventusit të dielën dhe trajneri Stefano Pioli njoftoi se ai do të mungojë në dy ndeshjet e ardhshme kundër Torinos dhe Cagliariar.

Ibrahimović do ta kontrollojë gjurin edhe një herë javën e ardhshme por, sipas "La Gazzetta dello Sport", lëndimi i tij është më i rëndë seç mendohej dhe suedezi do të mungojë edhe në ndeshjen

e fundit të Milanit kundër Atalantës. Suedezi pritet të rikthehet pas një muaji, kur edhe fillon "Euro 2020", që është lajm i mirë për ekipin e tij kombëtar të Suedisë.

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
-----------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------

DREJTORIA E ARSIMIT
05nr. 890 datë 11.05.2021

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.10/2018 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

KONKURS
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

- SHIFMU "Dëshmorët e Greikocit" në Greikoc**
Një mesimdhënës/e e mesimit klasor
- SHIFMU "Edit Durham" në Mushisht-Parlelja në Delloc**
Një mesimdhënës/e e mesimit klasor për kohë të caktuar deri në përfundimin e mandatit të drejtorit rishpallje

Kushtet: Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHI nr.10/2018

- SHIFMU "Sadri Duhla"-Duhël, paralelen në Dragaqinë**
Një Punëtor teknik/ndihmës

Detyrat dhe përgjegjësitë për punëtor ndihmës:

- ✓ Përgjigjet për pastrimin e gjithë hapësirave të shkollës, pajisjeve të shkollës dhe objekteve përcjellëse.
- ✓ Përgjigjet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e oborrit të shkollës në aspektin e mbajtjes së ambientit dhe kultivimin e gjelbërimit.
- ✓ Me punën dhe angazhimin e vet të krijojë një ambient të pastër, të kulturuar dhe të përshtatshëm për zhvillimin normal të procesit mësimor
- ✓ Kryen edhe detyra të tjera të cilat ia cakton drejtori, zv. drejtori ose zyrtari administrativ.

Kualifikimi : Shkolla fillore
Paga(koeficienti): 4



Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diploma e shkollës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHT(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës. Afati i konkurimit 15 ditë (pesëmbëdhjetë) nga dita e publikimit të konkursit në gazetë

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së

Drejtori i DKA-së
Remzi Bajselmani

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
-------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------

DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05 br. 890 od 11.05.2021 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03 / L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosova br. 04 / L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosova br. 03 / L-068, AI br.10 / 2018 (Normativa o stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), AU br.05 / 2015 (Normativa za nastavnike stručnog obrazovanja), Administrativnog uputstva br.07 / 2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Opštinska direkcija za obrazovanje objavljuje sledeće:

KONKURS
Za popunu slobodnih radnih mesta


- OSNS "Deshmoret e Greikoci"-Greikoc**
Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu(
- OSNS "Edit Durham" Mušitište-Delovec**
Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu (do zaveršetka mandata direktora škole)

Uslövi: -Za ova slobodna radna mesta objavljena na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br. 10 / 2018 .

- OSNS „ SHIFMU " Sadri Duhla " -Dragaqine**
-Jedan tehnički / pomoćni radnik
Dužnosti i odgovornosti za pomoćno osoblje:
Odgovora za čišćenje svih prostorija škole, školske opreme i pratećih objekata,
Odgovora za čišćenje i održavanje školskog dvorišta u smislu očuvanja životne sredine i negovanja zelenila,
Sa svojim radom i angažovanjem stvoriti čisto, kultivisano i prikladno okruženje za normalan proces učenja.
Izvršava druge dužnosti koje odredi direktor, zamenik direktora ili administrativni službenik.
Kvalifikacija: osnovna škola
Plata (koeficijent): 4

Dokumentacija potrebna za konkurs:
• Obrazac (prijava) koji kandidat popunjava
• Diploma ili potvrda stepena stručne spreme umesto diplome, koja ne sme biti starija od šest meseci (fotokopija).
• Izvod rođenja
• Lična karta (fotokopija)
• Dokaz o radnom iskustvu u obrazovanju (ako ga ima)
• Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)
• Kompletirani dokumenti se dostavljaju fotokopirano, dok će se originalni dokumenti predstavljati u intervjuu.
Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka.
Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelariju u Opštini Suva Reka.
Konkurs ostaje otvoren 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja u novinama.
O rasporedu intervjuja bićete obavesteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj tabli ODO.

Direktor ODO
Remzi Bajselmani



Infrakos

“Infrakos” Sh.a. njofton të gjithë të interesuarit për dhënien e pronës me qira.

Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” Sh.A. njofton të gjithë të interesuarit për dhënien e pronës me qira.

Shpallja do të jetë e hapur deri me 07.06.2021.

Për kushtet, dokumentacionin dhe informatat tjera ju lutem referojuni web faqes www.infrakos.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 5353/20 të datës 30.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomandë:
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
<http://mmph-rks.org/>
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Valdet Qollaku B.I.” ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 80667639 me nr. UNIK Identifikues 810616881 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Valdet Qollaku B.I.” donelo odluku o prestani rada sa nr. 80667639 me nr. UNIK Identifikues 810616881, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Valdet Qollaku B.I.” has come to the decision to quit its nr. 80667639 me nr. UNIK Identifikues 810616881, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ Trofta Fresh” Sh.p.k. Dobërçan, Gjilan , në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hurdhën për rritjen e peshkut në Dobërçan, Gjilan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.06.2021 në ora 11:00 në Restaurant Planeti ne hyrje te Gjilanit do të organizohet debat publik nga Kompania “Trofta Fresh” Sh.p.k. Dobërçan, Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Dobërçan, Gjilan Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:

<https://us04web.zoom.us/j/9662771284?pwd=dXgzVW9BalhjS3IKdEVTV1F0>

NTFvZz09

Meeting ID: 966 277 1284

Passcode: 112233

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ Trofta Fresh” Sh.p.k. Dobërçan, Gjilan për Dobërçan, Gjilan https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ Adalja ” Sh.p.k. Pejë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin e produkteve të duhanit- nargjilës në Z.K. Vitomiricë, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 04.06.2021 në ora 09:00 në Lokalet e kompanise Adalja shpk e cila gjendet ne Vitomirice komuna e Pejesdo të organizohet debat publik nga Kompania “ Adalja ” Sh.p.k. Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin e produkteve të duhanit-nargjilës në Z.K. Vitomiricë, Pejë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=UmQvcFNUNGQrZVFOM3RnU0d2K283Zz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ Adalja ” Sh.p.k. Pejë, për prodhimin e produkteve të duhanit- nargjilës në Z.K. Vitomiricë, Pejë.

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Hilmo Maksuti shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren..

► Detart Grajcevi shpall të pavlefshme ID-kartelen e lëshuar nga Kolegji AAB, Prishtinë.

► Idriz Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Lekë Dukagjini " Prizren.

► Ibrahim Kroni shpall të pavlefshme dëftesën e vitit III shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



Telekomi i Kosovës, Sh. A.

Në mbështetje të Ligjit të punës 03/L-212, neni 8, neni 10, pika 2 (2.3) dhe në bazë të nenit 4, të Udhëzimit Administrativ për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik (MPMS) Nr. 07/2017 të Republikës së Kosovës, Telekomi i Kosovës Sh. A. shpall:

**KONKURS PUBLIK
PËR 2 VENDE PUNE ME KONTRATË PËR PUNË DHE
DETYRA SPECIFIKE**


Mënyra e aplikimit:

- Kandidatet duhet ta plotësojnë Aplikacionin për Punësim, që gjendet në: www.kosovotelecom.com. Së bashku me aplikacionin duhet të dorëzohet edhe CV e detajuar, letër motivuese, dëshmi për punësim dhe dëshmitë e kualifikimeve,
- Aplikacionet mund të parashtrihen në njërin prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës.
- Aplikacionet duhet të dorëzohen në ndërtesën kryesore të Telekomit të Kosovës në Prishtinë, Dardania, kati gjashtë zyra e arhivës.
- Afati i fundit për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit, përkatesisht deri me 27.05.2021.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.
- Kontrata e punës lidhet me afat të caktuar për 120 ditë.
- Kandidatët që plotësojnë kriteret e kërkuara do të ftohen në test/interviste.

Ekspert Ligjor (2 ekzekutues)- Grada 15

Detyrat, kualifikimet dhe përgjegjësitë kyçe:

1. Kandidatët të jenë jurist të diplomuar, me përvojë të mirë /dëshmuar profesionale në procese aksione legale posaçërisht arbitrazhe ndërkombëtare dhe vendore ;
2. Preferohet provim i jurisprudencës dhe specializime përkatëse në arbitrazhe;
3. E domosdoshme përvoja e dëshmuar e angazhimit në së paku 1 arbitrazh në ICC ose ekuivalent në arbitrazhe ndërkombëtare , 1 arbitrazh në arbitrazhet nacionalë të Kosovës,
4. E preferueshme: përvoja në Gjykata ndërkombëtare, gjykata speciale, gjykata kushtetuese dhe gjykata nacionale supreme dhe të apelit;
5. Me preference të lartë është njohja e gjuhës angleze ose ndonjë gjuhë tjetër të BE,;
6. Njohja e mirë e materies së raporteve komerciale-kontratave , kontratave me element të huaj, përgatitja e opinioneve legale etj.
7. Puna në ekip dhe puna nën presion –janë të vlerës së madhe për punëdhënësin
8. Njohja e tregut dhe Industrisë së Telekomunikacionit.
9. Shkathtësi të forta ndër-personale me aftësi për t’u ndihmuar grupeve të ndryshme drejt efikasitetit operativ.
10. Shkathtësi të forta analitike, për zgjidhjen e problemeve dhe aftësi organizative.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejta

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Abrrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

